



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:143210  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05526830

**Ac.nr.6168/2021**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Adnan Konushevcu Kryetar i Kolegjit, Naime Ahmeti dhe Ylber Shurdhiqi anëtarë, në çështjen Kontestimore te paditësit F.H nga fshati V, Komuna e V..., të cilin me autorizim e përfaqëson, Xhevat Bici, avokat në Prishtinë, Rruga “Dukagjini”, nr. 128/A, kundër të paditurit, F.M nga fshati V, Komuna e V..., të cilin e përfaqëson, Ekrem Pira, avokat në Komunë e Vitisë, me bazë të kontestit dorëzim i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 10, 000.00 Euro, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega ne Viti C.nr.159/14 të datës 24.05.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN te pa bazuara ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurit F.M nga fshati V, Komuna e V..., dhe ankesa e të autorizuarit të paditësit ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega ne Viti, C.nr.159/14 të datës 24.05.2021 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.159/14 të datës 24.05.2021, në pikën I (një) ka vendosur: Detyrohet i padituri F.M që paditësit F.H, t’ia lirojë dhe dorëzoj pjesën e sipërfaqes prej ... m2 të ngastrës .....ZK Viti, e cila nga ana veriore kufizohet me ngastrën 3608-3, në gjatësi prej 4, 19 m, në pjesën lindore dhe jugore me ngastrën ....., në gjatësi 4.93 + 3, 95 m, në pjesën perëndimore me ngastrën 2592-11 në gjatësi 4, 23 + 3, 09 m, në pjesën veriperëndimore me ngastrën 3608-2 në gjatësi 1, 07 m, në pjesën lindore me ngastrën 2565-1

në gjatësi prej 5, 52 m, të largojë objektin e lokalit afarist me sipërfaqe prej 25 m<sup>2</sup> si dhe të largojë pllakën e betonit, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë kanë parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, për shkak të vendimit mbi shpenzimet me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoi ankesën dhe të ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar në piken II. Të dispozitivit dhe të detyroi të paditurin që të paguaj shpenzimet e procedurës në shume prej 1,570.00 euro si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.
- Ankesa e paditësit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar padi me datën 14.05.2014, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin, C.nr.159/14 të datës 24.05.2021, me të cilin është vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se në baze të nenit 36 paragrafi 1, të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (tani e tutje LPDS) është përcaktuar se: “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuarit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”, ndërsa me nenin 93 të këtij ligji është paraparë se “Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”.

Sipas kësaj dispozite ligjore, pronari e ka të drejtën e kërkesës së kthimit të sendit të caktuar prej secilit që nuk ka të drejtë posedimi. Për gjykatën, vendimtar ishte fakti se paditësi është pronar i ligjshëm i paluajtshmërisë që ishte objekt në këtë kontest, ndërsa, i padituri pa bazë ligjore e mbanë pjesën e sipërfaqes së kësaj paluajtshmërie dhe objektin e identifikuar qartë në këtë

paluajtshmëri, dhe mbi këtë bazë edhe e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura e gjithashtu edhe në faktin se i padituri, nuk e ka asnjë bazë ligjore për mbajtjen apo shfrytëzimin e pjesës së paluajtshmërisë dhe objekteve në këtë paluajtshmëri, gjykata vlerëson se me këto veprime, i padituri i ka cenuar të drejtat pronësore të përcaktuara në nenin 18 par. 1 të LPDS, sipas të cilit “Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”. Sipas kësaj dispozite ligjore, prona e huaj mund të shfrytëzohet apo të përdoret vetëm nëse ekziston pëlqimi i pronarit apo nëse ka bazë juridike të vlefshme për një gjë të tillë.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurit, të cilat gjeti si të pa bazuara dhe të pa mbështetshme me asnjë provë. Pretendimi i të paditurit se paluajtshmërinë kontestuese e ka blerë nga Ekrem Shahini është i pa rëndësishëm në këtë proces kontestimor pasi që, nuk kishte kundërkërkesë për vërtetim të së drejtës së pronësisë. Gjithashtu, edhe pretendimi se paditësi nuk e ka pasur në posedim paluajtshmërinë kontestuese është i pa qëndrueshëm, për shkak se paditësi, si pronar i ligjshëm i kësaj paluajtshmërie, ka të drejtë të kërkojë kthimin e saj nga çdo kush që e mbanë atë pa bazë ligjore. Fitimi i pronësisë në sendet e paluajtshme, ndër të tjera, bëhet edhe me aktin e regjistrimit si pronar në regjistrat publikë ashtu siç përcaktohet në nenin 36 paragrafi 1 të LPDT.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të cilat i ka pretenduar pala paditëse me ankesë, gjendja faktike është vërtetuar si duhet e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është në kundërshtim me vetveten dhe me provat e deponuara. Aktgjykimi i atakuar është i qartë, dispozitivi është në përputhje me arsyetimin dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ka një harmoni logjike dhe juridike në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit të atakuar, pastaj janë dhënë arsye për faktet

vendimtare, procedurën e provave vlerësimin e provave nga të cilat ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Dispozitivi i aktgjykimi të arsyetuar është i plotë dhe i përshtatshëm për përmbartim pasi identifikon pjesën e pronës kontestuese lëndore, shtrirjen dhe përkufizimin e së njëjtës dhe kërkon nga i padituri lirim të së njëjtës dhe dorëzimin, pra nuk ka kërkesa për rrënim, apo kërkesa tjera që fizikisht do të lidheshin me pronën të cilën e mban personi tjetër.

Në rastin konkret edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nga e cila gjendje ka rezultuar se pronar i pronës/lokalit kontestues është paditësi, sikurse është vërtetuar se të njëjtën e shfrytëzon i padituri në mënyrë indirekte sepse ia ka dhënë me qira apo për shfrytëzim personit tjetër, por që nuk e konteston se mban të njëjtën, sikurse i padituri po ashtu nuk kishte kërkesë të tij si kundërpadi gjë që do të mund të vërtetonte bazën juridike të mbajtjes apo posedimit, për të vërtetuar se e mban mbi një bazë të caktuar, pasi vetëm në atë mënyrë kërkesëpadia e paditësit do të refuzohej, përndryshe deklaratimet e pambështetura në prova rreth bazës së mbajtjes nuk e legjitimojnë të paditurin si mbajtës me të drejtë apo bazë të pronës pronësinë e të cilës e ka paditësi. Identifikimi i pronës është bërë me ekspertizë të gjeodezike, ku është përcaktuar sipërfaqja, shtrirja dhe përkufizimi, mendimi i ekspertit është objekti dhe profesional që me të drejtë edhe Gjykata e Apelit ia fal besimin këtij mendimi.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i palës së paditur për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi gjykata në rastin konkret drejtë ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale.

Me nenin 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore përcaktohet se: *“Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi.”* Ndërsa me nenin 94.1 të LPDS-së përcaktohet se: *“Poseduesi mund të refuzojë kthimin e sendit, nëse ai ose poseduesi indirekt, prej të cilit ai e derivon (nxjerrë) kërkesën e tij për posedim ka të drejtë posedimi.”* Me nenin 97.1 dhe 2 të LPDS-së përcaktohet se: *“1. Poseduesi është me keqbesim nëse ai ose detentori (mbajtësi) i tij ishte në dijeni ose ka mund të dijë, se nuk kanë pasur të drejtë posedimi. 2. Si posedues me keqbesim konsiderohet edhe poseduesi nga çasti kur pronari kërkon kthimin e sendit ose kur paraqitet kërkesa sipas nenit 95 të këtij ligji.”* I padituri nuk është posedues me mirëbesim dhe rrjedhimisht të drejtën e posedimit nuk e ka mbi një bazë të vlefshme juridike, andaj kundërshtimet e të njëjti janë i relevante, sepse ka qenë detyrë e tij që me rastin e paraqitjes së pretendimeve të tij të provojë bazën e posedimit, pra se posedimin e sendit e ka mbi

një bazë, në të kundërtën pronari në çdo kohë ka të drejtë kthimin e sendit prej poseduesit jo pronar.

Nuk qëndron pretendimi ankimore i palës paditëse në raport me shpenzimet, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 463.1 të LPK-së me të cilën përcaktohet se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.”* Nga procesverbali i seancës kryesore i datës 24.05.2021, konstatohet qartë se kërkesa e palës paditëse e shprehur përmes të autorizuarit për shpenzime ka qenë kërkesë e pa specifikuar por si total ku ka kërkuar shpenzimet e procedurë në lartësisë prej 1,570.00 euro, andaj për kërkesa të pa specifikuara drejtë ka vendos gjykata që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedural, ndërsa për palën e paditur drejtë ka vendosur sepse të njëjtës nuk i takon kompensimi i shpenzimeve sepse pala e paditur e ka humbur kontestin.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk kishin ndonjë ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo që u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6168/21 me datë 28.03.2024**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
Adnan Konushevci